



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 128, Datë 01/10 /2014

Bazuar në nenin 32, pika 3 dhe nenin 33, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenin 85, pika 3, të Kodit të Proçedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N :

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e z. [Emri i personit], me Nr. 05 regj, datë 31.01.2014, në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, nga znj. [Emri i personit], Drejtor, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve.

Sipas shpjegimeve të dhënë nga subjekti ankues deklaroi se, që nga viti 1992 ka punuar pranë sistemin tatimor në detyra të ndryshme, dhe nga muaji Maj 2012 është emëruar Drejtor Rajonal i Tatimeve Shkodër deri më datë 20.01.2014 kur është larguar nga detyra mbështetur në rezultatet konkursit të zhvilluar me datë 24.12.2013. Pavarësisht rezultateve të këtij konkursi, ankuesi pretendon se duhet të ishte ulur një nivel më poshtë dhe jo të dilte jashtë sistemit të administratës tatimore. Gjatë periudhës së shërbimit në administratën tatimore nuk ka marrë asnjë masë disiplinore si dhe ka zhvilluar karrierën profesionale brenda sistemit tatimor. Ankuesi shpjegon se i përket shtresës së të përndjekurve politikë dhe me bindje politike të djathta e cila është dhe arsyeja kryesore e largimit nga puna.

Për marrjen e informacionit dhe grumbullimin e provave të nevojshme për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës në datë 31.07.2014 u zhvillua inspektimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Gjatë zhvillimit të inspektimit nga ana e Drejtores së Drejtorisë Ligjore pranë DPT u kërkua më shumë kohë për përgatitjen e informacionit krahasues të kërkuar në Urdhrin e Inspektimit nr. 112, datë 25.07.2014.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Duke pasur parasysh se informacioni i kërkuar është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes, bazuar në nenin 85, pika 3, të Kodit të Proçedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- Pezullimin e procedimit administrativ të çështjes së z. ...
- Ky vendim përfundon pas administrimit të provave dhe fakteve për zgjidhjen e ankesës.
- Ngarkohet Drejtoria e Hetim-Inspektimit dhe Inspektori që ndjek çështjen për zbatimin e këtij vendimi.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

REPUBLICA E SHQIPËRIE
KOMISIONI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
TIRANË



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al